



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NDËRMARRJA SHËRBIMEVE KOMUNALE DURRËS

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot

Durrës, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale për rrethimin e vend depozitimeve
të mbetjeve urbane me konstruksion metalik”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44334000-0

NUMRI I REFERENCËS SË PROCEDURËS: REF – 97883-08-27-2026

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.624.474 (pesë milion e gjashtëqind e njëzet e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh.

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe studimit të tregut, fondi limit u përlllogarit bazuar në mesataren e cmimeve të marra nga ky studim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: *"...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP *"Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"*, Neni 82, i LPP *"1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të disponojë, gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, të paktën 1 (një) Inxhinier Mekanik, i cili të jetë i punësuar pranë operatorit ekonomik ose të angazhohet nëpërmjet kontratës së punës/shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomën e Inxhinierit Mekanik;

- Dokumentacionin që provon marrëdhënien e punësimit ose kontraktuale me operatorin ekonomik;

Inxhinieri Mekanik duhet të jetë i disponueshëm dhe të angazhohet për nevojat e zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Ky kriter quhet i përmbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9., dhe në bazë të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. .”.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e të paktën një Inxhinieri Mekanik është përcaktuar në përputhje me nenin 45 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në blerjen e materialeve për realizimin e rrethimit të venddepozitimeve të mbetjeve urbane me konstruksion metalik. Përmbushja e kontratës kërkon njohuri dhe kompetenca teknike në fushën e materialeve dhe konstruksioneve metalike, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së materialeve të furnizuara me specifikimet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Disponimi i një Inxhinieri Mekanik synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale të nevojshme për të trajtuar dhe vlerësuar aspektet teknike që lidhen me materialet dhe elementet metalike objekt furnizimi, si dhe për të ofruar mbështetjen e nevojshme teknike gjatë zbatimit të kontratës. Kërkesa është e lidhur dhe proporcionale me objektin e prokurimit, pasi synon të sigurojë që operatori ekonomik ka personel profesional të përshtatshëm për menaxhimin dhe përmbushjen e kërkesave teknike të kontratës dhe për garantimin e cilësisë së materialeve të furnizuara.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën një salditor me çertifikatë profesionale. OE duhet të paraqesë dokumentat si më poshtë:

- Kontraten e punës sipas legjislacionit.
- Çertifikatën Profesionale të lëshuar nga organet kompetente.

Ky kriter quhet i permbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9., dhe ne baze të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”.

Argumentimi: Kërkesa për disponimin e të paktën një saldatori me certifikatë profesionale është përcaktuar në përputhje me nenin 45 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin materiale dhe elemente të destinuara për realizimin e rrethimit me konstruksion metalik të venddepozitimeve të mbetjeve urbane. Këto materiale janë të destinuara për t’u përdorur në një konstruksion metalik, ku përpunimi dhe bashkimi i elementeve metalike, sipas rastit, kërkon njohuri dhe aftësi profesionale të posaçme. Disponimi i një saldatori me certifikatë profesionale synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale të nevojshme për trajtimin dhe përpunimin teknik të elementeve metalike që lidhen me objektin e furnizimit, si dhe për realizimin e proceseve të saldimit që mund të jenë të nevojshme në funksion të përgatitjes dhe përshtatjes së materialeve. Kërkesa për certifikatë profesionale synon të sigurojë që personeli i angazhuar për proceset e saldimit disponon kualifikimin dhe aftësitë e nevojshme profesionale, duke kontribuar në garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe sigurisë së elementeve metalike që do të përdoren për realizimin e rrethimit. Kërkesa është përcaktuar në mënyrë proporcionale me objektin dhe natyrën teknike të kontratës dhe synon garantimin e kapaciteteve profesionale të operatorit ekonomik për përmbushjen e kërkesave teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i*

përbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/b citohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përbushur me sukses kontratën. Gjithashtu vendosja e kriterëve në reference është bërë që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, i cili rregullon kriteret për procedurat e hapura të thjeshtuara.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë përvojën e nevojshme për realizimin e kontratës. Për këtë arsye, është kërkuar që përvoja e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit, në përputhje me kufijtë e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i kësaj vlere është bërë në mënyrë proporcionale, duke marrë në konsideratë natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e kontratës objekt prokurimi, me qëllim garantimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë që zotërojnë kapacitetin teknik dhe përvojën e nevojshme për realizimin e saj. Njëkohësisht, kjo kërkesë nuk tejkalon nivelin e nevojshëm dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi është vendosur brenda marzheve të lejuara nga legjislacioni përkatës dhe u jep mundësi pjesëmarrjeje një game të gjerë operatorësh ekonomikë. Në këtë mënyrë, kriteri për kontrata të ngjashme shërben si një instrument i rëndësishëm për

vlerësimin e aftësisë teknike të operatorëve ekonomikë, duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, transparent dhe efektiv.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në çdo kohë sipas kërkesave të AK në sasinë dhe cilësinë e këkuar.

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar, sipas të cilave autoriteti kontraktor mund të kërkojë prova që vërtetojnë aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik për realizimin e kontratës. Deklarata me anë të së cilës operatori ekonomik merr përsipër të kryejë transportin e mallrave me shpenzimet e veta deri në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore në çdo kohë sipas kërkesave të AK në sasinë dhe cilësinë e këkuar, kërkohet për të garantuar përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktore dhe furnizimin e mallrave në vendin e dorëzimit, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën dhe vlerën e kontratës, nuk krijon kufizime të pajustificuara për konkurrencën dhe siguron që ofertuesi të ketë kapacitetin organizativ për të realizuar shpërndarjen e mallrave në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

3. Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë **të paktën 1(një)** automjet për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi, me qira ose përdorim.

Për sa me sipër operatori ekonomik ofertues të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi ,ose qira, ose përdorim

Shenim 3.1: Për mjetet me status përdorimi qira ose hua përdorje të disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarrësit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve. Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë ofertues duhet të

paraqesin dokumentacionin e mesiperm prane Autoritetit Kontraktor jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit perfundimtar.

Ky kriter quhet i permbushur me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9, dhe ne baze të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, sipas të cilit: “6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike...”

Argumentim: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 4 të Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me Ligji nr. 16/2024, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për përmbushjen e kontratës. Kërkesa për këto mjete dhe pajisje është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, konkretisht me nevojën për transportin dhe shpërndarjen e materialeve të pastrimit në adresat e autoriteteve kontraktore, duke garantuar realizimin korrekt dhe në kohë të shërbimit. Në këtë mënyrë, përdorimi i Formularit të Vetëdeklarimit (Shtojca 9) në fazën e ofertimit lehtëson pjesëmarrjen dhe redukton barrën administrative për operatorët ekonomikë, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumenteve provuese në fazën e vlerësimit perfundimtar siguron verifikimin e plotë të kapaciteteve të deklaruara, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, në përputhje me nenin 26, pika 1 dhe pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar, ku parashikohet se autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake vetëdeklarimin e operatorit ekonomik në vend të dokumenteve të lëshuara nga autoritetet publike apo palë të treta. Pra, operatorët ekonomikë, në momentin e paraqitjes së ofertës, duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 9), duke deklaruar përmbushjen e kriterëve të kërkuara, përfshirë edhe disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në zbatim të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të

ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari paraqitjen e dokumenteve provuese që vërtetojnë saktësinë e vetëdeklarimit, si dhe dokumentacionin shoqërues të ofertës, të dorëzuar në rrugë elektronike.

4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në SPE Deklaratë në të cilën të marrë përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike duke cilesuar për çdo produkt sipas kërkesave të AK si dhe realizimin e kontratës sipas afatit 20 ditor.

Argumentim: Në bazë të nenit 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, vendosja e këtij kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u siguruar se operatori ekonomik merr përsipër të ofrojë materialet objekt prokurimi në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për deklarimin e përmbushjes së specifikimeve teknike për çdo produkt është e nevojshme duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në blerjen e materialeve për realizimin e rrethimit të venddepozitimeve të mbetjeve urbane me konstruksion metalik. Materialet e furnizuara duhet të përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, pasi cilësia dhe karakteristikat e tyre ndikojnë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë, sigurinë dhe funksionalitetin e konstruksionit metalik që do të realizohet. Përcaktimi i afatit prej 20 ditësh për lëvrimin e materialeve është i nevojshëm dhe i justifikuar nga natyra e furnizimit objekt prokurimi, pasi materialet janë të nevojshme për realizimin në kohë të rrethimeve të venddepozitimeve të mbetjeve urbane. Sigurimi i tyre brenda një afati të përshtatshëm është i rëndësishëm për të mundur vijimin e procesit të realizimit të rrethimeve dhe për të garantuar përmbushjen në kohë të nevojave të Autoritetit Kontraktor. Afati 20-ditor është përcaktuar me qëllim që të sigurohet furnizimi në kohë i materialeve, pa krijuar vonesa që mund të ndikojnë në realizimin e rrethimeve dhe në vijimësinë e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane, duke garantuar njëkohësisht që Operatori Ekonomik të ketë një afat të përshtatshëm për realizimin e furnizimit sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

5. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë Certifikatën ISO Si me poshte:

- Ofertuesit duhet të paraqesin Çertifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësive dhe /ose të njëvlefshme, të cilat do të garantonin

cilesine e produktit ose standart ISO me e avancuar, e perkthyer e noterizuar. Çerfikata duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues.


Ne Çertifikaten ISO 9001:2015 duhet te jete e perfshire Objekti i prokurimit.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e Certifikatës ISO 9001:2015 të prodhuesit, ose të një standardi ekuivalent/më të avancuar, është përcaktuar në funksion të natyrës dhe destinacionit të materialeve objekt prokurimi, të cilat do të përdoren për realizimin e rrethimit të venddepozitimeve të mbetjeve urbane me konstruksion metalik. Në përputhje me nenin 40 dhe nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, si dhe kërkesa që lidhen me cilësinë dhe përputhshmërinë e mallrave objekt prokurimi, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa mbështetet gjithashtu në dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, lidhur me kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional dhe dëshmitë që mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktor. Materialet që do të furnizohen do të përdoren për realizimin e rrethimeve me konstruksion metalik të venddepozitimeve të mbetjeve urbane dhe do t’i nënshtrohen përdorimit të vazhdueshëm dhe kushteve të ndryshme të shërbimit. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka nevojë të sigurohet se prodhuesi i produkteve të ofruara disponon një sistem të dokumentuar të menaxhimit të cilësisë dhe procese të kontrolluara për prodhimin e tyre. Kërkesa që objekti/fusha e certifikatës të lidhet me prodhimin e produkteve objekt prokurimi synon të sigurojë që certifikimi të ketë lidhje reale me aktivitetin dhe produktet që do të furnizohen. Kërkesa për vlefshmërinë e certifikatës dhe lëshimin e saj nga organizma të akredituar synon të sigurojë autenticitetin, besueshmërinë dhe verifikueshmërinë e dokumentacionit të paraqitur. Kriteri është vendosur duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe lidhjes me objektin e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit të materialeve dhe elementeve metalike që do të furnizohen për realizimin e rrethimit të venddepozitimeve të mbetjeve urbane.

6. Operatori Ekonomik Pjesemarres ne daten e zhvillimit te tenderit do te paraqese mostrat e produkteve si me poshte:

Nr	Emertimi i Mallit	Sasia
1	Profil Kemb TI	1
2	Profil Kembe Kend	1
3	Profil perforcues	1
4	Lamarin ballore	1
5	Llamarine anesore	1
6	Bulona kok çader Ø 8	1
7	Dado exagonale me frenues najloni per bulona kok çader Ø 8	1
8	Upa ekspres Ø 12	1


1. Profil Kembe TI



Profili duhet te jete δ 2.5

Baza duhet te jete δ 8

2. Profil Kembe KEND




Profili duhet te jete δ 2.5

Baza duhet te jete δ 8

3. Profil perforcues


3



Profili duhet te jete δ 2.5

4. Lllamarin ballore


4



Llamarina duhet te jete δ 2.5

4.1 Kthimi i llamarines


4



Kthimi Llamarines

5. Llamarine anesore

5




Llamarina duhet te jete δ 2.5

6. Bulona kok çader Ø 8


7. Dado ekzagonale me frenues najloni per bulona kok çader Ø 8

6 + 7



+ Bulon - $\phi 8$
+ Dada

8. Upa ekspres Ø 12+ Dado ekzagonale me frenues najloni



Shenim: Referuar udhezimeve te APP, per zerat ne DST qe mund te jete paraqitur marke/brand, operatoret ekonomik mund te ofertojne ekuivalente te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike.

Shenim: Mosdorezimi i informacionit te sakte apo dorezimi te rreme do te konsiderohet kusht per skualifikim dhe/ose fillim te hetimit administrativ per perjashtim te O.E. nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara

Argumentim: Kjo kërkesë është e bazuar në nenin 40, pika 6, shkronja “a”, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, i cili parashikon mundësinë që Autoriteti/Enti Kontraktor t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të

dorëzojnë mostra të mallit, kur gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Kërkesa për paraqitjen dhe administrimin e mostrave mbështetet gjithashtu në Udhëzimin Nr. 03, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”. Kërkesa për paraqitjen e mostrave është përcaktuar duke pasur parasysh natyrën e objektit të prokurimit, konkretisht blerjen e materialeve dhe elementeve metalike për realizimin e rrethimit të venddepozitimeve të mbetjeve urbane me konstruksion metalik. Mostrat i japin mundësi Autoritetit Kontraktor të verifikojë në mënyrë konkrete përputhshmërinë e produkteve të ofruara me specifikimet teknike, përmasat, materialin, formën, trashësinë, përpunimin dhe karakteristika të tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për paraqitjen e një mostre për secilin nga 8 zërat është e nevojshme pasi secili prej tyre ka funksion dhe rol të veçantë në realizimin dhe montimin e konstruksionit metalik, si më poshtë:

1. Profil këmbë TI: Mostra kërkohet për të verifikuar përmasat, formën, trashësinë, materialin dhe përpunimin e profilit, i cili shërben si element mbështetës i konstruksionit. Verifikimi fizik është i nevojshëm për të garantuar që profili përputhet me specifikimet teknike dhe siguron mbështetjen e nevojshme të konstruksionit.
2. Profil këmbë kënd: Mostra kërkohet për të verifikuar dimensionet, këndin, trashësinë, materialin dhe përpunimin e profilit, i cili përdoret në pjesët këndore të konstruksionit. Përputhshmëria e tij me specifikimet teknike është e rëndësishme për realizimin e saktë të këndeve dhe lidhjeve të konstruksionit.
3. Profil përforcues: Mostra kërkohet për të verifikuar dimensionet, trashësinë, formën dhe materialin e profilit që shërben për përforcimin e konstruksionit. Ky element ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë dhe rezistencën e rrethimit dhe, për këtë arsye, karakteristikat e tij duhet të verifikohen fizikisht.
4. Lllamarinë ballore: Mostra kërkohet për të verifikuar materialin, trashësinë, dimensionet dhe përpunimin e llamarinës ballore, e cila shërben si element i rrethimit dhe mbulimit të konstruksionit. Verifikimi i saj siguron përputhshmërinë me kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara.
5. Lllamarinë anësore: Mostra kërkohet për të verifikuar trashësinë, dimensionet, materialin dhe përpunimin e llamarinës anësore, e cila përdoret në pjesët anësore të konstruksionit. Verifikimi fizik është i nevojshëm për të garantuar që materiali është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar dhe përmbush specifikimet teknike.
6. Bulona kokë çadër Ø 8: Mostra kërkohet për të verifikuar diametrin, gjatësinë, formën e kokës, materialin dhe përpunimin e bulonit. Bulonat shërbejnë për lidhjen dhe fiksimin e elementeve të konstruksionit dhe për këtë arsye përputhshmëria e tyre me specifikimet teknike është e rëndësishme për qëndrueshmërinë e lidhjeve.
7. Dado ekzagonale me frenues najloni për bulona kokë çadër Ø 8: Mostra kërkohet për të verifikuar dimensionet, përputhshmërinë me bulonat Ø 8, materialin dhe karakteristikën e frenimit me najlon. Dadoja është pjesë e drejtpërdrejtë e sistemit të fiksimit dhe frenuesi prej najloni shërben për të siguruar qëndrueshmërinë e lidhjes gjatë përdorimit të konstruksionit.

8. Upa ekspres Ø 12: Mostra kërkohet për të verifikuar diametrin, dimensionet, materialin dhe karakteristikat e elementit të ankorimit. Upa ekspres shërben për fiksimin e elementeve të konstruksionit në sipërfaqen mbështetëse dhe, për këtë arsye, përputhshmëria e saj me specifikimet teknike është e rëndësishme për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e rrethimit.

Në tërësi, paraqitja e mostrave për secilin prej 8 zërave i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar në mënyrë konkrete karakteristikat fizike dhe teknike të produkteve të ofruara dhe për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa është vendosur në mënyrë proporcionale me objektin e prokurimit, pasi kërkohet vetëm një mostër për secilin zë dhe secila mostër lidhet drejtpërdrejt me funksionin dhe përdorimin e materialit përkatës në realizimin e rrethimit me konstruksion metalik të venddepozitimeve të mbetjeve urbane.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM:

Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;


b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

SPECIFIKIME PER “BLERJE MATERIALE PER RRETHIMIN E VEND DEPOZITIMEVE TE MBETJEVE URBANE ME KONSTRUKSION METALIK”

Specifikime:


1. Profil Kembe TI



Profili duhet te jete δ 2.5

Baza duhet te jete δ 8


2. Profil Kembe KEND



Profili duhet te jete δ 2.5


Baza duhet te jete δ 8

3. Profil perforcues



Profili duhet te jete δ 2.5


4. Lllamarin ballore



Lllamarina duhet te jete δ 2.5

4.1 Kthimi i llamarines


4



Kthimi i llamarines

5. Llamarine anesore


5



Llamarina duhet te jete δ 2.5


6. Bulona kok çader Ø 8

7. Dado ekzagonale me frenues najloni per bulona kok çader Ø 8




8. Upa ekspres Ø 12+ Dado ekzagonale me frenues najloni

8




Upa ekspres metalike $\phi 12$


9. Montim ne terren i kollonave me llamarinat




Montimi i kllones kend



Montimi i kllones TI



Montimi i profilit perforcues



Montimi final

- Materiali duhet te jete i gjithi i xinguar
- Materiali duhet te jete i gjithi i lyer me boje puder elektrostатike, ne furre me pjekje
- Kthimet, Prarjet, Shpimet e vrimave, saldimit dhe çdo punim tjetër mbi material duhet te behet perpara xingimit dhe lyerjes
- I gjith material i te jete i amballazhuar per te eliminuar gerrvishjet.
- Bulonat dhe dadot te jene te paketuara
- Ngjyra do te percaktohet nga AK

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Nr	Artikulli	Njesia	Sasia
1	Profil Kembe TI	Cope	252
2	Profil Kembe Kend	Cope	104
3	Ptprofil perforcues	Cope	384
4	Llamarin balllore	Cope	192
5	Llamarine anesore	Cope	108
6	Bulona kok çader Ø 8	Cope	7020
7	Dado ekzagonale me frenues najloni per bulona kok çader Ø 8	Cope	6966
8	Upa ekspres Ø 12	Cope	1408
9	Montim ne terren i kollonave me llamarinat	ML	422,24

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Malli do të levrohet nga operatori ekonomik që do shpallet fitues i cili duhet të njoftojë 1 ditë përpara për lëvrimin e mallit, ku të përcaktohet sasia, njësia dhe emri i shoqëruesit të mallit.
- Malli do të dorëzohet në prani të komisionit të marrjes në dorëzim në Magazinen e NSHK Durres, lagja 4, rruga Egnatia.
- Furnizimi do të bëhet 20 ditë nga nënshkrimi i kontratës, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.
- Montimi do të kryhet pas furnizimit të mallit objekt prokurimi. Ora dhe vendi i montimit do të përcaktohet nga AK.

Ofertuesi fitues do të shoqëroj mallin me këto dokumentacione:

- Faturen Tatimore e Mallit
- Situacionin sipas zerave.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë fotokopje të noterizuara ose origjinale

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar., **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet Teknike gjenden ne shtojcen 6 te Dokumentave Standarte te Tenderit.

Argumentimi teknik: Specifikimet teknike për objektin e prokurimit “Blerje materiale për rrethimin e vend depozitimeve të mbetjeve urbane me konstruksion metalik” janë hartuar në përputhje me nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor dhe me kërkesat teknike dhe funksionale që duhet të përmbushë konstruksioni metalik që do të realizohet.

Përcaktimi i profileve metalike, llamarinave, elementëve të fiksimit, ankorimit dhe shërbimit të montimit është bërë duke marrë në konsideratë funksionin që këto materiale do të kenë në realizimin e rrethimit të vend depozitimeve të mbetjeve urbane, si dhe nevojën për një konstruksion të qëndrueshëm, të sigurt dhe të përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme.

Trashësitë e përcaktuara për profilet dhe llamarinat janë vendosur si kërkesa minimale teknike, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë mekanike të konstruksionit, rezistencës ndaj deformimeve dhe jetëgjatësisë së tij gjatë përdorimit. Ndërkohë, përcaktimi i elementëve të fiksimit dhe ankorimit është i nevojshëm për realizimin e lidhjeve të sigurta ndërmjet pjesëve të konstruksionit dhe për fiksimin e tij në terren. Kërkesa që materialet të jenë të zinkuara dhe të

lyera me bojë puder elektrostатike, në furrë me pjekje, është përcaktuar për të garantuar mbrojtjen e konstruksionit nga korrozioni dhe ndikimi i kushteve atmosferike, duke qenë se rrethimi do të vendoset në ambiente të jashtme dhe do të jetë i ekspozuar ndaj reshjeve, lagështirës dhe faktorëve të tjerë të mjedisit.

Kërkesa që të gjitha proceset e përpunimit të materialit, si kthimet, prerjet, shpimet, saldimet dhe punimet e tjera, të realizohen përpara zinkimit dhe lyerjes, synon të ruajë integritetin e shtresës mbrojtëse dhe të shmangë dëmtimin e saj pas përfundimit të trajtimit të materialit. Gjithashtu, kërkesa për ambalazhimin e materialeve dhe paketimin e veçantë të bulonave dhe dadove është përcaktuar për të garantuar ruajtjen e tyre gjatë transportit, magazinimit dhe dorëzimit, duke shmangur dëmtimet e sipërfaqes dhe humbjen e elementëve të vegjël të montimit.

Përfshirja e montimit në terren në objektin e prokurimit është e nevojshme për shkak të natyrës së materialeve dhe objektit përfundimtar që kërkohet të realizohet. Montimi do të përfshijë vendosjen dhe fiksimin e kolonave, profileve përforcuese, llamarinave dhe elementëve të lidhjes, duke garantuar që materialet e furnizuara të realizojnë funksionin e tyre si një konstruksion i vetëm dhe i qëndrueshëm. Specifikimet teknike janë përcaktuar duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, duke përcaktuar karakteristikat minimale teknike dhe funksionale të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe jo një markë, prodhues apo origjinë të caktuar. Specifikimet teknike të përcaktuara janë të nevojshme për të garantuar që materiali i furnizuar dhe montimi i realizuar të sigurojnë një rrethim metalik të qëndrueshëm, funksional, të sigurt dhe rezistent ndaj kushteve të jashtme, në përputhje me nevojat e Autoritetit Kontraktor dhe qëllimin e përdorimit të tij.